



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 7, Datë 29. 3 2011

PER
PROCELUREN E KONVERTIMIT TE LICENCES KOMBETARE TE PERSONELIT
TE MIREMBAJTJES SE AVIONIT, NE LICENSE TE KUFIZUAR TE
MIREMBAJTJESIT AERONAUTIK

Në përputhje me nenin 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 33 të Ligjit Nr. 10040 datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Qellimi

Percaktimi i procedurave për konvertimin e licencave kombetare të personelit të mirembajtjes së avionit në Licence Mirembajtjesi Aeronautik të Kufizuar, si faze kalimtare e procesit të njohjes së licencave brenda Zonës së Perbashkët të Aviacionit Evropian.

2. Fusha e Zbatimit

Ky Udhëzim zbatohet për personelin e mirembajtjes së avionit i cili zoteron një licence kombetare, të cilët para hyrjes në fuqi të Udhëzimit të Ministrit Nr. 2, datë 02.02.2011 “Për procedurën e lëshimit, rinovimit, ndryshimit në objekt, pezullimit dhe revokimit të licencës së personelit të mirembajtjes së avionit”, ushtronin këto funksione në baza të deklaramentit të “Ripranimit në Sherbim” (Release to Service).

2.1. Në këtë fazë kalimtare licencat e konvertuara do të kenë vlerë vetëm në zonë kombetare. Për momentin mbetet e papercaktuar një datë brenda së cilës të konvertohen licencat kombetare.

2.2. Për teknikat e mirembajtjes në klasat motor dhe përberes, siç parashikohet nga nenpjesa C e pjesës 66 të Udhëzimit të Ministrit Nr. 16 datë 14.10.2008 “Për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve të pajisjeve aeronautike dhe mbi aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, mbeten në fuqi

dispozitat Urdherit te Ministrit Nr. 97, date 19.06.1996 "Per rregulloren e e licensimit te personelit fluturues dhe te mirembajtjes"

3. Procedurat e Konvertimit

3.1. Dokumentacioni qe aplikanti do te paraqese duhet te permbaje:

3.1.1. Kerkesen per konvertim tek Autoriteti i Aviacionit Civil,

3.1.2. Formularin e plotesuar Mod. 19 bis EASA (v. shtojca 1)

3.1.3. Dosjen permbledhese te aktivitetit se punes te raportuar ne dosjen e konvertimit (v. *shtojca 2*).

Kjo dosje duhet te jete e pergatitur nga kompania e mirembajtjes, prane se ciles punon aplikanti dhe e firmosur nga Menaxheri i Cilesise se kesaj kompanie.

3.2. Autoriteti i Aviacionit Civil, vlereson dokumentacionin shoqerues ne mbeshtetje te kerkeses dhe krahason te dhenat qe perfshihen ne dosjen e konvertimit me ato te dosjes se kandidatit, e depozituar ne arkivin e Autoritetit.

3.3. Autoriteti i Aviacionit Civil pasi verteton vlefshmerine e kesaj dosje dhe kufizimet e perfshira ne te, leshon LMA-ne me kufizime ne permbajtje (*Mod. shtojca 3*).

3.4. Autoriteti i Aviacionit Civil ka te drejten te mos konvertoje ose te kufizojte privilegjet e LMA-se, nese licensa qe paraqitet per konvertim, rezulton te jete leshuar ne mosperputhje me legjislacionin kombetar.

3.5. Ne procesin e konvertimit do merren parasysh dhe vleresohen dhe licensat e leshuara sipas formularit te parashikuar nga JAR 66 ose pjesa 66.

3.6. Kriteret e konvertimit te licenses kombetare paraqiten si vijon:

3.6.1. Licensat kombetare Tip I mund te konvertohen ne Kategori A (shih shenimi 1);

3.6.2. Licensat kombetare Tip II mund te konvertohen ne Kategori B1/B2/C (*shih shenimi 1, shenimi 2*).

Shenimi 1: Licensat e leshuara me Formularin JAR-66 ose EASA Formularin 26 nuk do konvertohen nese zoteruesit e ketyre Formulareve (JAA o EASA 26) nuk tregojne te kene marre me pare nje license kombetare tip sipas pikave 1 ose 2.

Shenimi 2: Eshte e mundur te behet konvertimi ne kategorine B2 dhe/ose C nese kerkuesit tregojne qe kane ushtruar perkatesisht privilegjet e sektorit elektro-aeronautik dhe/ose ne sektorin e "mirembajtjes baze".

3.7. Para konvertimit te licenses kombetare ne LMA te kufizua, nuk eshte e mundur te behen modifikime ne license (shtim kategorie/nenkategorie ose futje te aftesive te reja).

3.8. Ne aktin e leshimit te LMA-se te kufizuar, licensa kombetare korresponduese anulohet zyrtarisht.

4. Kufizimet e paraqitura ne LMA-n

LMA-te e leshuara pas procesit te konvertimit do te permbajne kufizimet qe derivojne nga mungesat e njohurive baze ne lidhje me ato te parashikuara ne programin mesimor te shtojces III te pjeses 66. *Kufizime* te tilla nuk demtojne privilegjet relative te kategorive/nenkategorive te paraqitura ne licensen e konvertuar.

Kufizimet e parashikuar jane si meposhte:

4.1. Per avione me Peshë Maksimale ne Fluturim (M.T.O.W). me te larte se 5700 Kg (Konvertim ne Kategorite B1, B2, C)

Kufizime	E Aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Per ata qe s'kane aftesi mbi avione turbohelike
Me përjashtim të avionëve të pajisura me helikë	Per ata qe s'kane aftesi mbi avione me helike
Me përjashtim të avionëve të pajisura me motor turboreaktiv	Per ata qe s'kane aftesi mbi avione me motor turboreaktiv
Përjashtuar helikopterët	Per ata qe s'kane aftesi mbi helikoptere

Per te hequr kufizimet e lartpermendura duhet te kalohen provimet perkatese per modulet vijuese ose nenmodulet baze:

Kufizimet	Moduli/nenmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (Motorët turbohelikë)
Me përjashtim të avionëve të pajisura helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisura motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15

4.2. Per avionet me Peshë Maksimale ne Fluturim (M.T.O.W) e njejte ose me pak se 5700 Kg (Konvertim ne Kategorine B1/B2/C)

Kufizimet	E Aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet me turbohelik
Me përjashtim të avionëve të pajisur me helikë	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet me helike
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet turboreaktiv
Përjashtuar helikopterët	Per ata qe nuk kane aftesi mbi helikopteret monomotorr
Përjashtuar avionet me MTOW mbi 5700 kg	Per te gjithë (pavaresisht nga aftesite te perfshira ne licensen kombetare)
Përjashtuar helikopterët multimotor	Per ata qe nuk kane aftesi mbi helikopteret multimotor
Përjashtuar avionic te avioneve te medhenj	Per ata qe kerkojne kategorine B2 nisur nga nje licence kombetare qe permban aftesite mbi avionet me MTOW me te vogel ose e njejte me 5700 Kg ose mbi helikopteret monomotorr

Per te hequr kufizimet e lartpermendura do te duhet te kalohen provimet perkatese mbi modulet e meposhtme:

Kufizimet	Moduli/nenmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (Motorët turbohelikë))
Me përjashtim të avionëve të pajisura helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15
Përjashtuar avionet me MTOW mbi 5700 kg	Per Kat.B1.1: M3, M5, M6, M11a, M15 Per Kat.B1.2: M3, M5, M6, M11a, M16 Per Kat.B2: M3, M5, M6, M13, M14 Per Kat.C: M3, M5, M6, M11a, M13, M14, M15
Përjashtuar helikopterët multimotor	Per Kat.B1.3: M3, M5, M6, M12, M13, M15 Per Kat.B1.4: M3, M5, M6, M12, M16 Per Kat.B2: M3, M5, M6, M13, M14 Per Kat.C: M3, M5, M6, M12, M13, M14, M15
Përjashtuar avionic te avioneve te medhenj	M3, M4, M5, M13, M14

4.3. Per avione me M.T.O.W. te njejte ose me te vogel se 5700 kg (Konvertim ne Kategorine A)

Kufizimet	E aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet me turbohelik
Me përjashtim të avionëve të pajisura helikë	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet me helike
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	Per ata qe nuk kane aftesi mbi avionet turboreaktiv
Përjashtuar helikopterët	Per ata qe nuk kane aftesi mbi helikopteret monomotorr
Përjashtuar avionet me MTOW mbi 5700 kg	Per te gjithë (pavaresisht nga aftesite te perfshira ne licensen kombetare)
Përjashtuar helikopterët multimotor	Per ata qe nuk kane aftesi mbi helikopteret multimotor

Per heqjen e kufizimeve te lartpermendura duhet te kalohen provimet relative ne modulet e meposhtme:

Kufizimet	Moduli/nenmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (Motorët turbohelikë)
Me përjashtim të avionëve të pajisura helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15
Përjashtuar avionet me MTOW mbi 5700 kg	M3, M5, M6, M11a
Përjashtuar helikopterët multimotor	M3, M5, M6, M12

Legjenda:

Module 3 Bazat elektrike
Module 4 Bazat elektronike
Module 5 Teknika Digital
Module 6 Materiale & Hardware
Module 7 Praktikat e Mirembajtjes
Module 8 Aerodinamika Bazike
Module 9 Faktorët Njerezor
Module 10 Legjislacioni i Aviacionit
Module 11 Sistemet e avioneve (mekanike)

12 Helicopter Systems (Mechanical)
13 Aircraft Systems (Avionic)
14 Propulsion (Avionic)
15 Turbine Engine
16 Piston Engine
17 Propellers

5. Aftesite

Aftesite qe duhet te perfshihen ne LMA, duhet te jene te listuara ne dosjen e konvertimit (all. 2). Ato perbehen nga llojet e vecanta te avioneve te perfshira ne licensen kombetare per t'u konvertuar.

6. Kufizime ne LMA: Shtesa Kategorie ose Njohje aftesie

6.1. Shtesa e kategorise/nenkategorise mund te kerkohet vetem pasi te hiqen nga LMA-ja kufizimet, te pranishme ne license, relative ndaj kategorise/nenkategorise se re.

Mundet te qendrojne ne license, pas shteses, ekskluzivisht kufizimet qe nuk kane lidhje ne asnje menyre me kategorie/nenkategorie e re subjekt shtese.

6.2. Kufizimet e permbajtura ne LMA-ne e "kufizuar" mund te hiqen duke dnene provimet perkatese ne modulet e parashikuara nga Shtojca III pjesa 66. Keto provime mund te jepen direkt prane organizatave te aprovuara ne pjesen 147 ose prane Autoritetit Kompetent ne vendet anetare te EASA-s.

Per te arritur heqjen e nje kufizimi ne license duhet paraqitur kerkesa e vecante tek Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas modaliteteve te treguara ne Formularin 19bis EASA.

7. Raste te Vecanta

Mund te paraqiten dy raste stafi teknik te huaj te mirembajtjes, i cili punon ne njeh organizate shqiptare mirembajtjeje te aprovuar te cilet zoterojne:

- 1. License LMA- EASA (nga shtete Anetare te Bashkimit Evropian)**
- 2. Licensa te tjera jo nga shtete te Bashkimit Evropian**

Për personelin referuar pikës (1), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të rivleresoje licensat EASA, duke i pajisur me nje license kombetare me një numër serial të ndryshëm nga ato te konvertuara dhe/ose te leshuara sipas Pjeses 66.

Keto licenca do te kene vlefshmeri 1 (njeh) vjeçare dhe ky proces do te jete i vlefshem deri ne momentin qeh Republika e Shqipërise do të jete antare e EASA-s me të drejta të plota.

Për personelin referuar pikës (2), Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do rivleresoje licensa të tilla.

8. Shtojcat

Shtojcat bashkelidhur jane pjese e ketij udhezimi dhe permbajne:

- Shtojca 1: Kerkesa per leshimin e LAM-se te "kufizuar" per konvertim (EASA Form 19bis)
- Shtojca 2: Dosja e Konvertimit
- Shtojca 3: Modeli A.M.L. (Form 26)

Ky Udhëzim hyn ne fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

SOKOL OLLDASHI

MINISTRI


34gPJESE 66 – Licenca e Kufizuar e Mirembajtesit ne Aviacion



Kerkese per leshim. L M A. te limituar per konvertim

Te Dhenat e kerkuesit:

Mbiemer _____ Emer _____
 Adresa _____ Qyteti _____
 Telefoni _____ Celular/E-Mail _____ / _____
 Kombesia _____ Vendi e data e lindjes _____

Te Dhenat e Licenses Kombetare per tu konvertuar ne LMA e kufizuar:

Licensa Kombetare Nr _____ Ndermarrja e Mirembajtjes Pjeses 145 n. _____

Informacion per ndermarrjen qe ka prezantuar skeden e konvertimit:

Emertimi i ndermarrjes _____
 Adresa _____
 Numeri i Certifikates se Aprovimit te ndermarrjes 145 _____
 Tel. _____ Fax _____

Kerkoj leshimin e nje LMA te kufizuar, ne kategorite, nenkategori dhe lejime ne vazhdimesi te treguara, per konvertim te Licenses Kombetare Nr. _____ e mbajtur nga une:

Klasifikimi	A	B1	B2	C
Avion me turbine	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A
Avion me pistona	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A
Helikopter me turbine	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A
Helikopter me pistona	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A
Avionik	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>	N/A
Mjet fluturues	N/A	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>

Lejime te kerkuara (jo te kerkuara per Kategorine A)

Tipi i mjetit fluturues (tregoni motorrin e instaluar)	Cat. B1	Cat. B2	Cat. C

- 1) Konfirmoj qe informacionet e paraqitura ne modulin present jane te verteta.
- 2) Konfirmoj gjithashtu qe jam i vetedijshem per kufizimet e LMA-se qe kerkoj dhe te faktit qe per te marre nje license te pa kufizuar eshte e nevojshme qe te mbrohen provimet qe i perkasin, sipas menyres te percaktuar nga ACAA.
- 3) Jam gjithashtu i vetedijshme per faktin qe prezantimi i deklaratave te falsifikuara paragjykon vlefshmerine e Licenses te leshuar per konvertim.

Mbiemer, Emer _____ Firma _____

Vendi dhe Data _____

SHTOJCA 2: SKEDA E KONVERTIMIT

Ndermarria _____

Certifikata e Aprovimit Pjesa 145 _____

Skeda e konvertimit ne LMA te kufizuar

Rezervuar ndermarrjes se aprovuar sipas Pjeses 145								Rezervuar per AAC
Mbiemer, Emer	Data e lindjes	Titulli i studimit	Perudha qe eshte kryer aktiviti prane ndermarrjes 145	Kurse te frekuencuar	Numri i Autorizimit te Certifikates	Kategori e nenkategori LMA se kerkuar	Tipi i mjetit futuru ¹	Kufizime per LMA
Firma e Manaxherit te Cilesise _____ Data _____								Pergjegjesi per AAC _____

¹ Tipet e mjeteve futuru¹se duhet te tregohen ne perputhje me ratings te parashikuar per vendosje ne AML, si ne Shtojcen I te AMC ne Pjeses 66

Shtojca 3: Modeli LMA (Forma 26)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL
SHQIPTAR
ALBANIAN CIVIL AVIATION AUTHORITY

LICENSE MIREMBAJTJE
AVIACIONI
AIRCRAFT MAINTENANCE
LICENSE

No. _____

KJO LICENSE NUK ESHTË E NJOHUR NGA SHTETET ANETAR
TE BE
THIS LICENSE IS NOT RECOGNISED BY EU MEMBER STATES

FORM 26

IV. Emri plote i mbajtesit IV. Full name of holder:
IVa. Data e vendi lindjes: IVa. Date and place of birth:
V. Adresa e mbajtesit V. Address of holder:
VI. Nacionaliteti i Mbajtesit VI. Nationality of holder:
VII. Firma e mbajtesit VII. Signature of holder:
VIII. Autoriteti VIII. Authority:
LIC No: _____

VIII. Kushtet
VIII. Conditions:

1. Kjo licensë duhet të firmoset nga mbajtesi dhe të jetë e shoqëruar me dokument identiteti që përmban fotografi të mbajtesit të licensës
This licence must be signed by the holder and be accompanied by an identity document containing a photograph of the licence holder.
2. Miratimi i cdo (nen)kategorie në faqen(t) e titulluar vetëm (NEN)KATEGORITE, nuk e lejon mbajtesin të leshojë certificate për futjen në shërbim për një mjet fluturues.
Endorsement of any (sub)categories on the page(s) entitled (SUB)CATEGORIES only, does not permit the holder to issue a certificate of release to service for an aircraft.
3. Kjo licensë kur miratohet me type rating për një mjet fluturues përmbush synimin e ICAO annex 1
This licence when endorsed with an aircraft type rating meets the intent of ICAO annex 1.
4. Kjo licensë është e vlefshme brenda datës së specifikuar në faqen e limitimit përveç se paraprakisht pezullohet ose revokohet
This licence remains valid until the date specified on the limitation page unless previously suspended or revoked.

LIC No: _____

IX. (NEN)KATEGORITE IX. (SUB)CATEGORIES				
Vlefshmeria: Validity:				
	A	B1	B2	C
Aviona me Turbine <i>Aeroplanes Turbine</i>			n/a	n/a
Aviona me Piston <i>Aeroplanes Piston</i>			n/a	n/a
Helikopter me Turbine <i>Helicopters Turbine</i>			n/a	n/a
Helikopter me Piston <i>Helicopters Piston</i>			n/a	n/a
Avioniks <i>Avionics</i>	n/a	n/a		n/a
Avion <i>Aircraft</i>	n/a	n/a	n/a	
Reserv <i>Reserved</i>				
LIC No: _____				

